

True to the Faith That Our Parents Have Cherished

By Elder Hans T. Boom
Of the Seventy

Të Vërtetë Ndaj Besimit që Prindërit Tanë Kishin për Zemër

Nga Plaku Hans T. Bum,
i Të Shtatëdhjetëve

April 2025 general conference

Please learn and receive strength from the faith and testimonies of those who came before you.

While I was visiting the Nashville Tennessee Temple for a temple review, I was privileged to do a walk-through as part of this assignment, reviewing this beautiful house of the Lord. I was especially impressed with the painting of Mary Wanlass called *Carry On* hanging on the wall in the office of the matron.

This is the story behind the painting:

“In Missouri in 1862, the 14-year-old Mary Wanlass promised her dying stepmother that she would see to it that her disabled father [and her four much younger siblings would all make] it to the Valley of the Great Salt Lake. ... Mary drove the oxen and milk cows that pulled the wagon, in which her father [was bedridden, and] she cared for her ... siblings. After each day’s journey, she fed the family by foraging edible plants, flowers, and berries. Her only compass was the instruction she had received to keep traveling west ‘until the clouds become mountains.’

“They reached [the] Utah Valley in September, having traveled all spring and summer. Her father died not long after the family settled in Utah County, where Mary later married and raised her [own] family.”

This is an amazing story of the faith and strength of a 14-year-old young woman that can help each one of us today to “just carry on.”

“Just carry on”—or freely translated in my native Dutch language, *Gewoon doorgaan*—is

Ju lutem të mësoni dhe të merrni forcë nga besimi dhe dëshmitë e atyre që jetuan përpara jush.

Teksa po vizitoja Tempullin e Neshvillit në Tenesi për një inspektim të tempullit, pata privilegjin ta shëtitja si pjesë e kësaj detyre, duke këqyrur këtë shtëpi të bukur të Zotit. Më bëri veçanërisht përshtypje piktura e Meri Uanlasit, e titulluar *Carry On* [Mos u Ndalni], e varur në murin e zyrës së kryekujdestares.

Kjo është historia që lidhet me pikturën:

“Në Misuri, në vitin 1862, 14-vjeçarja Meri Uanlasi i premtoi njerkes së saj në prag të vdekjes, se ajo do të bënte çmos që babai i saj me aftësi të kufizuara [dhe katër vëllezërit dhe motrat e saj shumë më të vegjël, që të gjithë, do të mbërrinin] në luginën e Grejt-Solt-Lejkut. ... Meri drejtonte qetë dhe lopët për qumësht, të cilat tërhiqnin karron ku [ishte i shtrirë] babai i saj, [dhe] ajo kujdesej për ... vëllezërit dhe motrat e veta. Pas çdo dite rrugëtimi, ajo e ushqente familjen duke rrëmuar për fruta pylli, lule dhe bimë të ngrënshme. Busulla e saj e vetme ishte udhëzimi që kishte marrë për ta vazhduar udhëtimin drejt përfundimit ‘derisa retë të puqeshin me malet’.

Ata mbërritën në Luginën e Jutës në shtator, pasi kishin udhëtuar gjithë pranverën dhe verën. I ati i saj vdiq jo shumë kohë pasi familja u vendos në kontenë e Jutës, ku Meri më vonë u martua dhe krijoi familjen e saj.”

Kjo është një histori mahnitëse e besimit dhe forcës së një të reje 14-vjeçare, që mund ta ndihmojë secilin prej nesh sot që “thjesht [të] mos ndal[emi].”

Fraza “Thjesht mos u ndal” ose që në gjuhën time amtare holandeze përkthehet fare thjesht-

also my mom and dad's lifelong slogan.

My parents and in-laws are the pioneers in our family. They have crossed their own "plains," just like all those who are coming into the Church, the Lord's fold, every day. Their stories have little to do with oxen and wagons but have the same effect on future generations.

They embraced the gospel and were baptized in their young adult years. Both my parents had a difficult childhood. My father grew up on the island of Java in Indonesia. During World War II, he was forcefully separated from his family and interned in a concentration camp, where he suffered unspeakable hardships at a young age.

My mother was raised in a broken home and also suffered from hunger and the hardships of World War II. At times she even had to resort to eating tulip bulbs. Due to her father's actions and his subsequent divorce from her mother, it was sometimes difficult for her to see Heavenly Father as a loving Father.

My parents met at a Church activity and shortly after decided to get married and sealed in the Bern Switzerland Temple. Waiting at the railway station, having spent the last of their little savings for the trip to the temple, they wondered how they would make ends meet but were confident that it would all work out. And it did!

They started to raise their family from a very humble single attic-room apartment in the heart of Amsterdam. After several years of washing their clothes by hand, they had finally saved up enough money to purchase a washing machine. Just before they would make the purchase, the bishop visited them, asking for a contribution to build the meetinghouse in Amsterdam. They decided to give all they had saved for the washing machine and continued to do the laundry by hand.

As a family we went through some hardships, just like any other family. These have only made us stronger and have deepened our faith in the Lord Jesus Christ, just like when Alma was sharing his story with his son Helaman, where he told him that he had been "supported under trials and troubles of every kind" because he had put his

Gewoon doorgaan, është edhe motoja që patën gjithë jetën mamaja dhe babai im.

Prindërit e mi dhe të bashkëshortes sime janë pionierët në familjen tonë. Ata kanë kapërcyer "rrafshnaltat" e tyre vetjake, sikurse të gjithë ata që po vijnë në Kishë, në vathën e Zotit, çdo ditë. Historitë e tyre nuk kanë të bëjnë shumë me qetë dhe karrot, por kanë të njëjtin ndikim te brezat e ardhshëm.

Ata e përqafuan ungjillin dhe u pagëzuan në vitet kur ishin të rinj e të reja në moshë madhore. Që të dy prindërit e mi patën një fëmijëri të vështirë. Babai im u rrit në ishullin e Javës, në Indonezi. Gjatë Luftës II Botërore, atë e larguan me forcë prej familjes së vet dhe e internuan në një kamp përqendrimi, ku vuajti vështirësi të papërshkrueshme që në moshë të re.

Nëna ime u rrit në një familje me prindër të ndarë dhe gjithashtu vuajti nga uria dhe vështirësitë e Luftës II Botërore. Në disa raste madje përfundoi deri aty sa të hante rrënjët e tulipanëve. Si rrjedhojë e veprimeve të të atit dhe shkurorëzimit të tij të mëvonshëm nga nëna e saj, ndonjëherë ishte e vështirë për të që ta shihte Atin Qiellor si një Atë të dashur.

Prindërit e mi u takuan në një aktivitet në Kishë dhe pas pak kohe vendosën të martoheshin e të vuloseshin në Tempullin e Bernës në Zvicër. Duke pritur te stacioni i trenit, pasi i kishin shpenzuar të gjitha kursimet e tyre të pakta për udhëtimin për në tempull, ata vrisnin mendjen se si do t'i plotësonin nevojat, por patën besimin se gjithçka do të shkonte mirë. Dhe ashtu ndodhi!

Ata filluan ta rritnin familjen e tyre nga një apartament shumë i thjeshtë në papafingo, me një dhomë të vetme, në zemër të Amsterdemit. Pas larjes së rrobave të tyre me dorë prej disa vitesh, ata më në fund kishin kursyer mjaft para për të blerë një lavatriçe. Pikërisht përpara se ta bënë blerjen, peshkopi u erdhi për vizitë, duke u kërkuar një kontribut për ndërtimin e shtëpisë së mbledhjeve në Amsterdam. Ata vendosën që t'i jepnin të gjitha ato që kishin kursyer për lavatriçen, dhe vazhduan t'i lanin rrobat me dorë.

Si familje, ne kaluam disa vështirësi, sikurse çdo familje tjetër. Këto veçse na kanë bërë më të fortë dhe e kanë thelluar besimin tonë te Zoti Jezu Krisht, ashtu si me Almën kur po ia tregon te historinë e tij birit të vet, Helamanit, ku i tha se kishte marrë "përkrah[je] në sprova dhe në shqetësime të çdo lloji" ngaqë e kishte vendosur

trust in the Lord Jesus Christ.

How did two people who experienced so many trials in their younger years become the very best parents I could ever wish for? The answer is simple: they fully embraced the gospel and live by their covenants to this very day!

After more than 65 years of marriage, my mother, who suffered from Alzheimer's disease, passed away in February. My father, at the age of 92 and still living at home, visited her as often as he could until she passed away. Some time ago he mentioned to my younger siblings that the dreadful experiences in the camp in Indonesia during World War II had prepared him to patiently care for his wife for so many years as she fell ill and deteriorated from this horrible disease and also for the fateful day he had to entrust her primary care to others and could not be by her side anymore. Their motto has been and still is to "Just carry on," having a perfect hope in Christ to be raised up at the last day and to dwell with Him in glory forever.

Their faith and testimonies are a driving strength for the generations that have come after them.

In the village where my wife grew up, her parents, who were good churchgoing people, embraced the gospel as a young married couple with my wife as their two-year-old daughter and only child at that time. Their decision to become members of The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints had a great impact on their lives as they were shunned by the villagers and by their family. It took many years, loving notes to family members, and service to the community before they were finally accepted.

On one occasion when my wife's father was serving as a bishop, he was falsely accused of something and was immediately released. My mother-in-law was so hurt that she asked her husband if they should continue to go to church. He answered that they of course would continue to go to church since this is not the church of men, but this is the Church of Jesus Christ.

It took some time before the truth came to

mirëbesimin e tij te Zoti Jezu Krisht.

Si u bënë dy njerëz që përjetuan kaq shumë sprova në vitet e tyre të rinisë, prindërit më të mirë që mund të kisha dëshiruar ndonjëherë? Përgjigjja është e thjeshtë: ata e përqaftuan plotësisht ungjillin dhe jetojnë sipas besëlidhjeve të tyre deri më sot.

Pas më shumë se 65 vjetësh martese, nëna ime, e cila vuante nga sëmundja e Alzheimerit, ndërroi jetë në shkurt. Babai im, me moshën 92-vjeçare dhe që ende jeton në shtëpi, e viziton-te atë sa më shpesh që mundte, derisa ajo ndërroi jetë. Ca kohë më parë, ai u përmendi vëllezërve e motrave të mia më të vogla se përvojat e tmerrshme në kampin në Indonezi gjatë Luftës II Botërore, e kishin përgatitur për t'u kujdesur me durim për bashkëshorten prej shumë vjetësh ndërsa ishte e sëmurë dhe përkeqësuar nga kjo sëmundje e tmerrshme, dhe gjithashtu për ditën tronditëse kur iu desh t'ua mirëbesonte përkuqdesjen kryesore për të njerëzve të tjerë dhe nuk mund të ishte më pranë saj. Motoja e tyre ka qenë dhe ende është: "Thjesht mos u ndal", duke pasur një shpresë të përkryer në Krishtin për t'u ngritur në ditën e fundit dhe për të banuar me Të në lavdi përgjithmonë.

Besimi dhe dëshmitë e tyre janë një forcë shtytëse për brezat që kanë ardhur pas tyre.

Në fshatin ku u rrit bashkëshortja ime, prindërit e saj, të cilët ishin njerëz të mirë që shkonin në kishë, e përqaftuan ungjillin kur ishin një çift i martuar në moshë të re, me bashkëshorten time si bijën e tyre dyvjeçare dhe të vetmin fëmijë në atë kohë. Vendimi i tyre për t'u bërë anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme pati një ndikim të madh në jetën e tyre ngaqë fshatarët e tjerë dhe familjarët e tyre i shpeshëputën tërësisht lidhjet me ta. U deshën shumë vjet, letra të përzemërta ndaj pjesëtarëve të familjes dhe shërbim në komunitet përpara se të pranoheshin përfundimisht.

Në një rast kur babai i bashkëshortes sime po shërbente si peshkop, ai u akuzua në mënyrë të rreme për diçka dhe u lirua menjëherë nga thirrja. Vjehrra ime u lëndua kaq shumë sa e pyeti bashkëshortin e vet nëse duhej të vazhdonin të shkonin në kishë apo jo. Ai u përgjigj se sigurisht që do të vazhdonin të shkonin në kishë përderisa kjo nuk është kisha e njerëzve, por është Kisha e Jezu Krishtit.

U desh ca kohë përpara se e vërteta të dilte

light and apologies were made. What could have been their breaking point just added to their strength and conviction.

Why is it that some of us take for granted the faith and testimonies of our parents who through all their hardships have remained faithful? Do we think that they do not have a clear understanding of things? They were not and are not deceived! They just have had too many experiences with the Spirit and can say with the Prophet Joseph, “I knew it, ... and I could not deny it.”

Don't you love the song about the army of Helaman, found in the Children's Songbook?

We have been born, as Nephi of old,
To goodly parents who love the Lord.
We have been taught, and we understand,
That we must do as the Lord commands.

Even when this might not be the case, as my mother experienced as a child, you can become one of those “goodly parents who love the Lord” and provide a righteous example to others.

Do we feel that this is absolutely true when we sing it? Do you feel that you are “as the army of Helaman” and that you “will be the Lord's missionaries to bring the world his truth”? I have felt it on so many occasions while singing this song in several FSY settings and other youth gatherings.

Or what do we feel when we sing the hymn “True to the Faith”?

Shall the youth of Zion falter
In defending truth and right?
While the enemy assaileth,
Shall we shrink or shun the fight? No!

True to the faith that our parents have cherished.

To those of the rising generation wherever you are and in whatever situation you may find yourself, please learn and receive strength from the faith and testimonies of those who came before you. It will help you understand that in order to gain or grow a testimony, sacrifices will have to be made and that “sacrifice brings forth the blessings of heaven.”

Thinking about a sacrifice that will truly bless your life, please consider and pray about the invitation of our beloved prophet, President Russell M. Nelson, when he asked “everyworthy, able young man to prepare for and serve a mission. For Latter-day Saint young men, missionary service is a priesthood responsibility. ...

në dritë dhe të kërkohej falje. Ajo që mund të kishte qenë pika e kulmit të durimit, vetëm sa ia shtoi forcën dhe bindjen.

Përse ndodh që disa prej nesh i marrin për të mirëqena besimin dhe dëshmitë e prindërve tanë të cilët, përmes gjithë vështirësive të tyre, kanë mbetur besnikë? A mendojmë se nuk kanë një kuptueshmëri të qartë të gjërave? Ata nuk ishin dhe nuk janë mashtruar! Thjesht kanë pasur tepër shumë përvoja me Shpirtin dhe mund të thonë bashkë me Profetin Jozef: “Unë e dija atë [gjë]... dhe nuk mund ta mohoja.”

A nuk ju pëlqen kënga për ushtrinë e Helamanit, që gjendet te Libri i Këngëve të Fëmijëve? “Erdhëm në jet’, si Nefi i lashtë,
Nga prindër të mir’ që Zotin duan.
Na është dhënë m’sim dhe ne e kuptojm’
Se duhet t’bëjm’ si Zoti urdh’ron.”

Edhe po të mos jetë ky rasti, sikurse përjetoi nëna ime kur ishte fëmijë, ju mund të bëheni njëri nga ata “prindër të mir’ që Zotin duan”, dhe të jepni një shembull të drejtë për të tjerët.

A e ndiejmë ne se kjo është absolutisht e vërtetë kur e këndojmë atë? A e ndieni se jeni “si ushtri[a] e Helamanit” dhe se ju “do je[n] i misionar’t e Zotit[,] t’vërtetën [e tij] t’s[illni] në bot’”? E kam ndier këtë në kaq shumë raste ndërsa e kënduam këtë këngë në disa mjedise të FSY-së dhe grumbullime të tjera të rinisë.

Ose çfarë ndiejmë kur këndojmë himnin “T’Vërtet’ Ndaj Besimit”?

“A do ngurrojn’ t’rinjt’ e Sionit
Në mbrojtjen e t’vërtetës?
Kur armiku po na sulmon,
A do i shmangemi luftës? Jo!
T’vërtet’ ndaj besimit të prindërve tanë.”

Pjesëtarë të brezit të ri kudo ku jeni dhe në çfarëdo situatë që mund të gjendeni, ju lutem të mësoni dhe merrni forcë nga besimi dhe dëshmitë e atyre që jetuan përpara jush. Kjo do t’ju ndihmojë të kuptoni se me qëllim që të fitoni ose ta rritni një dëshmi, do të duhet të bëhen sakrifica dhe se “sakrifica sjell të qiellit bekime”.

Duke menduar për një sakrificë që vërtet do ta bekojë jetën tuaj, ju lutem të merrni parasysh dhe të luteni rreth ftesës së profetit tonë të dashur, Presidentit Rasëll M. Nelson, kur i kërkoj “çdotë riu të denjë dhe të aftë të përgatitet dhe të shërbejë në një mision. Për të rinjtë shenjtorë të ditëve të mëvonshme, shërbimi misionar është

“For ... young and able sisters, a mission is also a powerful, but optional, opportunity.”

You could be called as a service or a teaching missionary. Both types of missionaries contribute to the same goal of bringing souls to Christ, each in their own unique and powerful way.

In both types of service, you will show the Lord you love Him and that you want to get to know Him better. Remember, “for how knoweth a man the master whom he has not served, and who is a stranger unto him, and is far from the thoughts and intents of his heart?”

All of us, whether we are the first generation in the gospel or the fifth, should ask ourselves, What stories of faith, strength, and celestial commitment will I pass on to the next generation?

Let us all continue in our efforts to get to know our Savior, Jesus Christ, better and to make Him the center of our lives. He is the rock upon which we must build so that when times become difficult, we will be able to stand firm.

Let us be “true to the faith that our parents have cherished, true to truth for which martyrs have perished, to God’s command, soul, heart, and hand, faithful and true we will ever stand.” In the name of Jesus Christ, amen.

një përgjegjësi priftërie. ...

Për motrat e reja dhe të afta, misioni është gjithashtu një mundësi e fuqishme, porme dëshirë.”

Ju mund të thirreni si misionar shërbimi ose mësimdhënieje. Të dy llojet e misionarëve japin ndihmesë drejt të njëjtit qëllim të sjelljes së shpirtave të Krishti, secili sipas mënyrës së vet të pashoqe dhe të fuqishme.

Në të dyja llojet e shërbimit, ju do t’i tregoni Zotit se e doni Atë dhe se dëshironi ta njihni Atë më mirë. Mbani mend, “pasi, si do ta njohë një njeri zotëruesin, të cilit nuk i ka shërbyer dhe që është i huaj për të, dhe është larg nga mendimet dhe qëllimet e zemrës së tij?”

Qofshim brezi i parë në ungjill apo i pesti, ne të gjithë duhet ta pyesim veten: Çfarë historish besimi, force dhe zotimi çelestial do të kaloj unë te brezi i mëpasshëm?

Le të vazhdojmë që të gjithë me përpjekjet tona për ta njohur më mirë Shpëtimtarin tonë, Jezu Krishtin dhe për ta bërë Atë qendrën e jetës sonë! Ai është shkëmbi mbi të cilin duhet të ndërtojmë që, kur kohët të bëhen të vështira, ne do të jemi në gjendje të qëndrojmë të palëkundur.

Qofshim “t’vërtet’ ndaj besimit të prindërve tan’, t’vërtet’ ndaj t’vërtetës për t’cilën u vran’, [si] Zoti urdhëron, [me] zemrën dhe dor’n, besnik, t’vërtet’ do qëndrojm’ gjithmonë”! Në emrin e Jezu Krishtit, amen.